**ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM TË PROVIMIT TË MATURËS NË GJIMNAZ, GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, GUSHT 2015**

**DETYRA 1. -1 pikë**
4. revolucion i vërtetë

**DETYRA 2. – Nxënësi/ja merr 2 pikë** nëse ka shkruar nën A): *Kulla e Ajfelit të përkujton në Revolucionin Industrial me dizajnin e vet dhe mekanizmin e vënies në lëvizje të ashensorëve, p.sh. shkallët spirale, rrotat shumë të mëdha që ngadalë i mbështjellin kabllot e trashë e të çelikta, dhe përgjigje tjera të ngjashme që janë të sakta;*
B) *Deri në majë të Kullës së Afelit arrihet me ashensorë nga platforma tjetër*
**Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka dhënë vetëm një përgjigje të saktë ose nën A) ose nën B).
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 3.** – **Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Kulla e Ajfelit është hapur në vitin 1889*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 4. – 1 pikë**
2. kishte rolin e transmetuesit të rëndësishëm

**DETYRA 5. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse përgjigjet: *300,65 m*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 6. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Veçanërisht është e rrezikshme puna e elektricistit, sepse qasja deri te llambat elektrike është shumë e vështirë për shkak të lartësisë së madhe, mund të jetë vdekjeprurëse edhe rënia e një vegle më të vogël të punës dhe përgjigje tjera të ngjashme që janë të sakta e që tregojnë sa është e rrezikshme puna e ndërrimit të llambave*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 7. – 1 pikë**
2. të paraqes faktet interesante nga themelimi i qytetërimit egjiptian

**DETYRA 8. – 1 pikë**

1. Mbretërisë së Re, gjegjësisht në kohën e Ramsesit

**DETYRA 9. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse është përgjigjur: *Faraonët nga Menesi grupohen në 30 dinasti, një sistem i përdorur edhe sot.*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 10. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Menesi mitik paraqitet veshur me rroba dhe shenja mbretërore në Paletën Narmer si simbol i aktit të bashkimit.*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 11. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Arsyet kryesore ishin kontrollimi lehtë i forcës punëtore dhe bujqësisë së rajonit pjellor të deltës ashtu si dhe rrugët tregtare të rëndësishme dhe fitimprurëse për në Levant.*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 12. – Nxënësi/ja merr 2 pikë** nëse ka dhënë sqarimin nën **A)** të domethënies frazeologjike – **<u>ç'i sheh syri ia bën dora</u>:** *Është mjeshtër për çdo punë, i vjen ndoresh për çdo gjë, e bën gjithçka shumë mirë etj*.
dhe nën **B)** ka shkruar një frazeologjizëm tjetër me domethënie të ngjashme, për shembull: *Çfarë nuk i bën dora*.
**Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka *dhënë përgjigjen e saktë ose nën A) ose nën B)*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 13. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka dhënë përgjigjen e saktë të funksionit sintaksor të fjalëve të nënvizuara nga fjalia e fundit në tekstin e dhënë: *Janë kallëzues i përbërë foljor*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 14. – Nxënësi/ja merr 2 pikë** nëse nën A) ka shkruar një sinonim të fjalës karakter nga konteksti i fjalisë së tekstit të dhënë si p.sh.**:** *shpirt, vendosmëri, burrëri, veti dalluese, tipar dallues, tip etj.* dhe nën B) ka caktuar antonimin e fjalës gjithçka - *asgjë*
**Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka *dhënë përgjigjen e saktë ose nën A) ose nën B)*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 15. – 1 pikë**

2. Gjergj Fishta

**DETYRA 16. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Gjinisë dramatike*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 17.- Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Për arsye se përdorte fjalë të ndryshuara nga Kongresi i Manastirit*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 18. – 1 pikë**

1. intervistë

**DETYRA 19. – 1 pikë**

3. lidhores

**DETYRA 20. – 1 pikë**

2. trajtë e shkurtër

**DETYRA 21. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Komizmi qëndron në faktin se doktori, në të vërtetë nuk ka zbuluar ndonjë ilaç mjekësor kundër sëmundjes, por ajo që bëri solli vdekjen.*
**Vërejtje**: Pranohen edhe përgjigje të ngjashme të sakta
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 22. – 1 pikë**

2. 1908

**DETYRA 23. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Poemës*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 24. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar**:** *Poeti me atë varg nënkupton , që jetojnë së bashku dy vajza ( dy motra) me nënën e tyre.*
**Vërejtje:** *Pranohen edhe përgjigje të ngjashme të sakta.*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 25. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar**:** *Është përdorur figura e krahasimit*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 26. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar**:** *Rimë të kryqëzuar*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 27. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Pëlcitëse*
**Nxënësi/ja merr 0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

**DETYRA 28. – Nxënësi/ja merr 1 pikë** nëse ka shkruar: *Urdhërore*
Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar**

**DETYRA 29. – 1 pikë**
4. Unë thashë se atëbotë kishim mirëqenie dhe rehati të mjaftueshme

**DETYRA 30. – Skema për vlerësimin e esesë**

**<u>1. GAVRILL DARA (I RIU) „KËNGA E SPRASME E BALËS“</u>**

**Përmbajtja 15 pikë**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi/ ja tregon:<br>1. periudhën letrare që i përket Dara (Romantizmit) *(1 pikë)*<br>2. për disa nga veprat që ka shkruar Dara (“Disa poezi”, “Ana Maria Komeniata”, “Kënga e sprasme e Balës” etj.) *(1 pikë)*<br>3. për gjuhën në të cilën ka shkruar Dara (italisht dhe shqip) *(1 pikë)*<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi/ ja:<br>1. shkruan për teknikën me të cilën Dara shkruan poemën (përdor “rrengun” duke manipuluar lexuesit se ai nuk ishte shkrimtar i veprës po stërnip i Balës dhe vepra i ra rastësisht në duar) *(1 pikë)*<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi/ ja:<br>1. shkruan për llojin poetik që i përket “Kënga e sprasme e Balës” *(1 pikë)*<br>2. thekson subjektin e poemës *(1 pikë)*; nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil. *(2 pikë)*<br>3. shkruan për personazhin Nikun dhe detyrën që kishte si luftëtar i Skënderbeut *(1 pikë)*<br>4. shkruan për vështirësitë që kalojnë dy të rinjtë pasi që njihen njëri me tjetrin *(1 pikë)*<br>5.tregon vdekjen e Nikut në betejën e Vajkalit si hero *(1 pikë)*<br>6. tregon për porosinë që i lë Niku bijës së Lalës para se të vdes *(1 pikë)*<br>**Gjithsej 7 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi/ ja:<br>1. shkruan për reagimin e Marës pas tragjedisë që sheh *(1 pikë);* nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil. *(2 pikë)*<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi/ ja:<br>1. bën zbërthimin e qartë dhe shkruan për domethënien e vargjeve “se, si u deshën përmbi dhe, ashtu duhen edhe nën dhe.”*(1 pikë);* nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil. *(2 pikë)*<br>**Gjithsej 2 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit 10 pikë**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| → origjinaliteti (interpreton me | → respektimi i normës | → lidhja e mirë në nivel të | → përshtatja e organizimit të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| fjalë të veta, hartimi bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale<br>**2 pikë** | gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale<br>**2 pikë**<br>→ respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave **r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, | tekstit dhe paragrafëve<br>**2 pikë** | përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)<br>**2 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br>**2 pikë**<br>**Gjithsej 4 pikë** | | |
| → përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta<br>**1 pikë** | → respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj.)<br>**1 pikë**<br>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të | → lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në nivel të paragrafëve<br>**1 pikë** | → ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit<br>**1 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br>**1 pikë**<br>**Gjithsej 2 pikë** | | |

## 2. KËRKIMI I JETËS NË MËRGIM E DREJTË APO GABIM?

**Përmbajtja – 15 pikë**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi /ja:<br>1. thekson qëndrimin që ka për braktisjen e vendlindjes *(1 pikë)*<br>2. thekson arsyet e braktisjes së vendlindjes *(1 pikë)*<br>3. argumenton qëndrimin e vet *(1 pikë)*<br>4. shkruan për fenomenin e shpërnguljes si një e drejtë apo hap i gabuar *(1 pikë)*<br>5. argumenton qëndrimin e vet *(1 pikë)*<br>**Gjithsej 5 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi / ja:<br>1. thekson ndonjë shembull që njeh ai/ajo që ka marrë rrugën e shpërnguljes nga vendlindja. *(1 pikë)*<br>*2.* përmend njerëzit që braktisin vendin e vet *(1 pikë)*<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi / ja:<br>1. thekson mundësinë e braktisjes së vendlindjes nga ana e tij dhe përse do ta bënte këtë *(1 pikë)*<br>2. argumenton qëndrimin e vet *(1 pikë)*<br>3. shkruan për pasojat e këtij fenomeni. *(1 pikë);* nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil *(2 pikë)*<br>4.thekson mundësinë e parandalimit të kësaj dukurie shqetësuese. *(1 pikë);* nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil *(2 pikë)*<br>**Gjithsej 6 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi / ja tregon:<br>1. për masat që duhet të ndërmerren për ndryshimin e kësaj gjendjeje që popullsia të qëndrojë në vendin e vet. *(1 pikë);* |

| | |
|---|---|
| | nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil *(2 pikë)*<br>**Gjithsej 2 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit 10 pikë**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| → origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale<br>**2 pikë** | → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale<br>**2 pikë**<br>→ respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i | → lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve<br>**2 pikë** | → përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)<br>**2 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | shkronjave **r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br>**2 pikë**<br>**Gjithsej 4 pikë** | | |
| → përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta<br>**1 pikë** | → respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj.)<br>**1 pikë**<br>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta | → lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në nivel të paragrafëve<br>**1 pikë** | → ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit<br>**1 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**) **1 pikë** **Gjithsej  2 pikë** | | |